



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 24.4.2024, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (i pa varur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Petrit Reçica (LVV), Driton Rukiqi (LDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arber Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rrëth pikave të rendit të ditës.

Doruntinë Maloku, drejtore propozoi që pikës së pestë ti ndryshohet emërtimi, të jetë Propozim vendimi për vazhdimin e kontratës së pronës së paluajtshme të Komunës qendrës sociale edukative “Don Bosko”.

Gëzim Sfelça, kërroi që pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës të korrigohet dhe të jetë: Propozim vendimi për zyrtarizmin e emrit “Parku memorial për personat e zhdukur me dhunë nga Serbia”. Po ashtu propozoi që pika e tetë e rendit të ditës, “Propozim vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara”, të zhvendoset në pikën e dytë të rendit të ditës.

Leutrim Retkoceri, propozoi që të bëhet anulimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010 të dt 05.09.2023.

Bekim Brestovci, drejtor propozoi që pika e dymbëdhjetë “Propozim vendimi sipas të cilit duhet të mirëmbahen të gjitha hapësirat publike ose private, vizualisht të dukshme nga rruga apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuale dhe të pastër të Kryeqytetit”, të hiqet nga rendi i ditës.

Jeta Rafuna, propozoi që të bëhet plotësim- ndryshimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të Donjeta Dragushes, anëtare e komitetit të caktohet Dhurata Jahaj -Retkoceri.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për, u miratua propozimi i Doruntinë Malokut, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për dhe një abstenim, u miratua propozimi i Gëzim Sveçlcs që të bëhet korrigimi i pikës së dymbëdhjetë.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 1 abstenim, u miratua popozimi që pika e tetë zhvendoset në pikën e dytë në rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 4 abstenime, pika e dymbëdhjetë zhvendoset në pikën e tretë në rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i Leutrim Retkocerit për anulimin e plotësim-ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës dhe të jet pika e katërt e rendit të ditës.

Me ndryshimet dhe plotësimet në rendin e ditës, kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, u miratua ky

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;**
- 3. Propozim-vendimi për zyrtarizimin e emërtimit të parkut memorial në oborrin e bibliotekës kombëtare “Të zhdukurit me dhunë nga Serbia”;**
- 4. Anulimi i plotësim-ndryshimit të rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010, të dt 05.09.2023;**
- 5. Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024;**
- 6. Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunkksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;**
- 7. Propozim-vendimi për nismën e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal;**
- 8. Propozim-vendimi për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës Sociale Edukative “Don Bosko”;**
- 9. Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projekt-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;**
- 10. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;**
- 11. Propozim-vendimi për plotësim ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera;**
- 12. Propozim-vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 13. Pyetje dhe përgjigje;**
- 14. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për mbështetje finançiarë të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara

Kryesuesi hapi diskutimin

Gëzim Sfeçla tha se është një kërkesë që ka ardhë prej shoqatës HANDIKOS e cila është një ndër organizatat më të vjetra që merren më personat me aftësi të kufizumë dhe qëllimi i kësaj është t’iu dalim në ndihmë personave më aftësi të kufizuar në mënyrë që ata të arrijnë ti marrin shërbimet e nevojshme sociale. Shuma e mjeteve e cila kërkohet për këtë rast është 41720 euro, ku me këto mjete finançiare do të mundësohet realizimi i qëllimeve të kësaj shoqate.

Sami Salihu tha se ne si grup parlamentar fuqishëm i përkrahim politikat sociale të Komunës të cilat duhet të janë dhe do të janë në përkrahje të kësaj kategorie shoqërore përmes organizatave kompetente që të janë në mënyrë vende ku bashkohen profesionistë të ndryshëm dhe që të kultivohet një ambient i këndshëm më një gamë të gjërë aktivitetesh ku do të këtë psikolog, fizioterapi, logoped si dhe punëtorë social.

Gresa Lahu tha se mungesa e një përkrahje të tillë të kësaj shoqate ka shkaktuar sfida reale dhe si shkak, pasojë e një vendimi të tillë për mbështetje finançiare është shkaktuar kosto e pa përballueshme për persona në nevojë, andaj është më se e domosdoshme që ne sot ta votojmë këtë propozim-vednim për mbështetje financiare të kësaj shoqate.

Sami Boroci tha se edhe ne e mbështesim këtë propozim-vendim, mirëpëo mendoj që kjo duhet me u bërë mbështetje e rregullt ose të bëhet një vijë bugjetore për këto organizata siç është HANDIKOSI-i dhe organizata tjera që trajtojnë këtë kategori për persona me nevoja të veçanta.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne do ta mbështesim këtë vendim për mbështetjen finançiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara. E konsiderojmë që është një moment i mirë, duke pasë parasysh që të gjitha grupet politike e mbështesim këtë pikë dhe e mbështesim pa dyshime mbarëvajtjen e vazhdueshme të kësaj organizate, si dhe jemi që përmes vijave bugjetore ta kenë një trajtim më të veçantë.

Fikneta Bejta tha se ne disa herë në Kuvend kemi diskutuar për problemet që ballafaqohen në këtë shoqatë dhe jemi pajtuar në kuadër të Planit të veprimit për personat më aftësi të kufizuar 2023-2025 të cilin plan e kemi votuar në Kuvend dhe jemi pajtuar që kjo shoqatë të jap shërbime edhe për fëmijë, për persona nën moshën 18 vjeçare edhe nëse

është kështu atëherë Komuna e ka për obligim me ju dalë në ndihmë financiare këtyre personave. Po ashtu pajtohem që për vitin 2024 të jet një kod i veçant buxhetor për këtë Lidhur me propozimet e dhëna rrith krijimit të një kodi të veçant buxhetor për mbështjejen financiare për përsat me aftësi të kufizuara, Valbona Makolli drejtore dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se më 45 vota për, u miratua Vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara.

Pika e tretë

Propozim- vendimi për zyrtarizmin e emërtimit te Parkut memorial në oborrin e bibliotekës kombëtare "Të zhdukurit me dhunë nga Serbia"

Gëzim Sfeçla tha se qëllimi për zyrtarizimin e këtij parku memorial është që të bëhet një vend ku familjet Prishtinase e sidomos studentët , duke e pasë parasyshë që bëhet fjalë në hapësirën afér Kampusit Universitar, të kenë një vend ku gjeneratë pas gjenerate do të përkujtohen dhe do të nderohen personat që na mungojnë të gjithëve e të cilët janë të zhdukur në luftën e fundit.

Jeta Rafuna kërkoi të dijë se ky propozim vendim a është në harmoni me ligjin. Po ashtu tha se do të ishte mirë që të formohet një komision nga Kuvendi si dhe nga drejtoria përkstëse për ta shqyrta komplet këtë dokumentacion.

Leutrim Ratkoceri tha se ne si grup parlamentar e përkrahim për votim këtë propozim - vendim.

Gëzim Mehmeti tha se e përkrahim për votim këtë propozim- vendim dhe njëherit i ftoi të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta përkrahim këtë propozim - vendim në shenjë nderimi të kaluarës.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne e mbështesim fuqishëm këtë propozim-vendim dhe besoj që është e nevojshme dhe e domosdoshme që kujtimin e këtyre personave mos të bëjnë vetëm me emërtime të shesheve të rrugëve, mirëpo edhe me projektet e ndryshme për të rikujtuar kujtesën historike dhe sakrificën e kombit tonë.

Kryesuesi konstatoi se më 44 vota për, u miratua Vendimi për zyrtarizmin e emërtimit te Parkut memorial në oborrin e bibliotekës kombëtare "Të zhdukurit me dhunë nga Serbia".

Pika e katërt

Anulimi i plotësim - ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunës e Prishtinës 01Nr 110-1203 e dt.

16.06.2010 të dt. 05.09.2023.

Leutrim Ratkoceri tha se si gup parlamentar kërkojmë që të bëhet anulimi i plotësim - ndryshimit të kësaj rregulloreje e dt. 05.09.2023, pasi që kjo rregullore ka sjellë probleme

rreth kufizimit të orareve të barnatoreve, andaj anulimi i këtij propozim- ndryshimi të rregullores nga nesër do të sillte ndalimin dhe hjekjen e kufizimit të orarit.

Plotësim- ndryshimi i kësaj rregulloreje i sjell në muajin shtator, që atë herë dhe sot ndajë mendim e njëjtë së nuk e ka pasur në qendër qytetarinë e Prishtinës. Propozimet e sjella dhe idetë e sjellura në formë individuale ato duhet të trajtohen, të diskutohen, të paratestohen dhe pastaj të sillen për votim dhe të hyjnë në fuqi.

Gëzim Sfelça tha se anulimi i këtij plotësim- ndryshimit të kësaj rregulloreje mendoj që e ndihmonë rregullimin kësaj çeshtjeje që është shumë etike për qytetarët e Prishtinës dhe natyrisht e përkrahim këtë propozim- vendim.

Fitneta Bejta tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim me anulimin e këtij plotësim ndryshimit të kësaj rregulloreje dhe kthimin në pikën zero të saj në ate të vitit 2010 dhe e inkurajojmë Drejtorin e Shëndetësisë dhe Kuvendin që sa më shpejtë të sjell propozimin për qitjen në debate publike këtë rregullore për plotësim- ndryshimin e saj dhe njëkohësisht edhe rregullimin e orarit të barnatoreve.

Gëzim Mehmeti tha se vendimi i cili është marrë në Kuvend, për shkak të mos informimit të drejt të qytetarëve do të ishte mirë që të jet një bashkëpunim me Oden e farmacisë, me barnatoret, me Shoqatën e distribuimit të produktiv të pajisjeve medicionale që së bashku të vijnë me një propozim që kishte me qenë i favorshëm për gjithë në këtë raste në shërbim të qytetarëve të Prishtinës .

Endrit Zabërgja tha se edhe ne e përkrahim anulimin e plotësim- ndryshimit të kësaj rregulloreje me arsyetimin se ajo çfarë kemi vërenjtur në teren ka pasur huti dhe mjegullina në raporte me zbatimin e kësaj rregullore.

Fiknete Bejta tha se anulimi i plotësim- ndryshimit të kësaj rregulloreje e ka përkrahjen edhe nga grupei parlamentar LDK-së, mirëpo me funksionua me rregulloren e vitit 2010 nuk është zgjedhja, duhet me punua për me rregulluar edhe problemin e mungesës së barnatoreve kujdestare.

Feim Osmani tha se rregullorja e vitit 2010 nuk është më e mira e mundshme, mirëpo në ankesat që janë paraqitur këtë muaj dhe që Komuna ska pasë mundësi apo vullnet të mirë të merret më këtë çeshtje, besoj që anulimi është më i drejtë dhe për arsyen së do ti jepët mundësia së paku orarit të vjetër deri në plotësim ndryshimin e rregullores. Mendoi se, Drejtoria e Shëndetësisë bashkë me Kuvendin duhet ti merrë parasyshë vërejtjet e të gjithave grupet të interesit, si dhe në raste edhe të Odës së farmacistëve.

Hafiz Krasniqi, ngriti një shqetësim i cili tha se barnatoret në përgjithësi nuk i respektojnë ligjet, udhëzimet administrative apo rregulloret si të nivelit qendrorë dhe lokal, për arsyen se ato jepin barna pa recetë të mjekut, kështu që ne duhet të bëjmë kërkesë që ta respektojmë vendimin e mjekut, e jo vendimin e qytetarit për ti shkruar barnat vetvetes.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Izet Sadiku, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për anulimin e plotësim - ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunës e Prishtinës 01Nr 110-1203 e dt. 16.06.2010 të dt. 05.09.2023.

Pika e pestë

Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua Vendimi për planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunktional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit

Lidhur me këtë pikë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Përparim Rama**, kryetar i cili tha se kjo marrëveshtje rrjedh nga iniciativa jonë e paraqitur edhe në konferencën e parë rajonale të organizuar nga Kryeqyteti më 11 mars 2022, ku kan dal 17 rekomandime të dakorduara në mesë të kryetarëve dhe zyrtarëve relevant të secilës komunë. Ky bashkëpunit ndërkomunal ka të bëjë në disa sfera si në ate të transportit urban, problemi i qenëve endacak dhe projektet tjera të cilat hyjnë në interes të qytetarëve.

Arbënore Berisha tha se ne si grup parlamentar e përkrahim këtë iniciativë dhe e votojmë këtë propozim- vendim.

Jeta Rafuna tha se grupi parlamentar i LDK-së e përkrah këtë iniciativë të bashkëpunimit ndërkomunal dhe mendoj që do të jet lehtësim i jetës së qytetarëve të gjashtë komunave të tjera.

Muhamed Selmani tha se edhe ne si grup parlamentar i përkrahim këto iniciativa, urojmë që këto të mos mbeten vetëm të shkruara por edhe të realizohen.

Gëzim Mehmeti tha se çdo lloj iniciative që është në shërbim të qytetarit, e përkrahim dhe do ta votojmë.

Endrit Zabërgja tha se iniciativat e tillë po ashtu që kanë rëndësi aktuale kanë edhe rëndësi strategjike, pa dyshim që do ta përkrahim këtë propozim- vendim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua Vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunktional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit

Pika e shtatë

Propozim- vendimi për nismën e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal

Lidhur me këtë propozim- vendim, Përparim Rama kryetar tha se kjo nismë e bashkëpunit ka për qëllim realizimin e projektit që është i një rëndësie të veçant për Kryeqytetin, për Komunën e Obiliq, Vushtrrisë, Podujevës dhe të Mitrovicës, për ndërtimin e një rruge të përbashkët që do ti lidhte këto komuna.

Faton Zeka tha se në emër të grupit parlamentar të LVV-së e mbështesim këtë propozim- vendim për iniciativën e kryetarit për bashkëpunim ndër- komunal, me shpresë që të aprovohet sa më shpejtë kjo marrëveshje në interes të qytetarëve të këtyre komunave.

Milazim Vitia tha se ne si GP i LDK-së e përkrahim ketë nismë të kryetarit dhe e votojmë këtë propozim -vendim për miratrim.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua Vendimi për nismën e kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal.

Pika e tetë

Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative "Don Bosko".

Arsyeshmérinë për votimin e këtij propozim- vendimit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë **Maloku**, drejtore.

Nora Kelmendi, fillmisht kishte vërejtje në pikën I të këtij propozim -vdenidmi e cila tha se nuk kemi të bëjmë me parcela por me parcelën në tërsi, kështu që kjo duhet të korrigohet. Po ashtu në kontratë duhet të specifikohet edhe koha e ndërtesave të ndërtuara në parcelë, ku aty janë ndërtuar gjashtë ndërtesa dhe pronësia e tyte pas skadimit te kontratës nuk dihet.

Ky institucion edhe pse deri tashë ka pasur kontratë valide, as një here nuk është regjistruar si qira mbajtës në aparatin kadastral. Pas regjistrimit ne emër të Don Boskos si shfrytëzues, duhet të fillohet me procesin e legalizimit të objekteve të cilat gjinden në ketë parcelë, pra duhet teknikisht pranë organeve kompetente, sidomos ndërtesat që janë në ndërtim e sipër. Nuk e kemi marrëveshjen, draft marrëveshjes nuk e dimë se qfarë do të ketë ajo draft marrëveshje e cila do të lidhët në emër të Komunës së Prishtinës dhe Don Boskos.

Ajet Brajshori tha se Qendra sociale edukative "Don Bosko" ka vite e cila bënë veprimtarinë e vetë edukativo arsimore në Prishtinë dhe normalisht që përmblushë standardet ndërkombëtare për zhvillimin e procesit mësimor. Ky është një institucion i cili mundëson trajnimin në fushat të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale qoftë menagjeriale qoftë në mësimdhëniet dhe në fusha tjera të zhvillimit të arsimit. Andaj duke e pasë parasyshë rëndisinë e këtij institucioni, si GP i LDK-së e mbështesim që ti vazhdohet kontrata për shfrytëzimin e pronës së Komunës së Prishtinës.

Faqe8nga16

Leutrim Retkoceri tha sa i përket këtij propozim- vendimi, ne si grup parlamentar qëndrimet tona i kemi dhënë në mbledhjen e KPF-së, andaj edhe përkrahja nga grupi i PDK-së do të jetë, mirëpo gjithmonë duke e pas parasysh që dokumentacioni të jetë i kompletuar dhe të jetë sa më transparente gjdo dhënie e pronës në shfrytëzim. E përkrahim këtë propozim- vendim për miratim.

Gëzim Sfeçla tha se mbetet që kryetari me u zotua që të gjitha këto vërejtje që u dhanë me qenë pjesë e kontratës, gjithashtu mu e zotua që posa të përfundoj kontrata në mesë Kryetarit dhe Don Bosko, të njëjtën të na e sjellë edhe neve në asamble.

Fatmir Dervishi, sa i përket këtij propozim- vendimi konsideroi se 50 vjet për dhënien në shfrytëzim janë shumë, andaj kërkoi nga kryetari që të shihet mundësia të bisedohet për më pak vjet.

Gresa Lahu tha se a ka mundësi që të shohim saktësish së qfarë është planifikua se çka investohet në atë hapësirë me qenëse periudha e dhënies në shfrytëzim është afat gjate, kështu që do të ishte më se korrekte që ta kemi një arsyetim sa më të plotë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerime e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Doruntinë Maloku, drejtore dhe përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstataoi se më 30 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative "Don Bosko".

Pika e nëntë

Propozim vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projekt rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës.

Lidhur me këtë propozim vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

Violeta Salihu tha se grupi parlamentar i LVV-së është pro-dërgimit në dëgjim publik të këtij propozim- vendimi për plotësim ndryshimin e rregullores edhe e kisha apelu që me pasë një informim sa më të madh te palët e interesit e në fokus të veçantë te qytetarët në mënyrë që të ballafaqohemi me vështirësitet dhe sfidat që i kanë pasur te dy palët. I ftoj të gjithë që të jemi prezent sa më shumë në këtë konsultim publik dhe të japim inputet tona, të nxjerrim më të mirën.

Fikneta Bejtë tha se, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim që të vendoset në diskutim publik dhe besojë që gjitha këto diskutime, vërejtje që do ti kemi për këtë rregullore gjatë debatit publik, do ti marrim dhe do ti shqyrtojmë pastaj që ta kemi një rregullore që me të vërtetë do ti zgjedhë të gjitha problemet.

Granit Geci tha se edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë iniciativë, mirëpo le të jetë si praktikë, që për qështjet që kanë interes vital për mirëqenien e qytetarëve ta kemi në qendër qytetarin dhe tani e tutje për çdo qështje të tillë ta krijojmë si

praktikë që të kemi konsultime publike, debate publike dhe të inkurajojmë të gjitha grupet e interesit që të marrin pjesë sa më shumë në këto debate.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, u miratua Vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projekt rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës.

Pika e dhjetë

Propozim – vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese Sinani dhe Selmani.

Lidhur me këtë pikë të rendit të të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Adelina Sahiti, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 31 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese Sinani dhe Selmani.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozim – vendimi për plotësimin, ndryshimin e vendimit për themelin e komiteteve të tjera.

Lidhur me këtë propozimvendim Gëzim Sveçla tha se, në vend të Besnik Mujecit, subjekti politik LVV, për anëtar të Komitetit për Shërbime Publike propozojmë Arbër Limanin.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për plotësimin, ndryshimin e vendimit për themelin e komiteteve të tjera.

Pika e dymbëdhjetë

Propozim – vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit për themelin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë propozim-vendim Jeta Rafuna tha se, në vend të zj. Donjeta Dragusha, subjekti politik LDK, anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, propozojmë znj. Dhurata Jahaj - Retkoceri.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit për themelin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e trembehjetë Pyetje dhe përgjigje

Gëzim Sveçla, për kryetarin e Komunës, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtoren e Drejtorisë së Kulturës, dhe për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit

- Eshtë një kërkesë prej Odës së farmacistëve në lidhje me një taksë që e paguajnë barnatoret e Komunës së Prishtinës në shumë prej 250 euro, taksë vjetore të cilën nuk e kanë komunat tjera, përpos Fushë Kosovës dhe Prishtinës, do të thotë këtë taksë e paguajnë vetëm barnatoret, dhe nuk e paguajnë laboratorët as poliklinikat as ordinancat, prandaj duhet shqyrtuar këtë mundësi që nëse është vetëm për Komunën e Prishtinës dhe nuk ka bazë ligjore, mendojë që nuk duhet ti penalizojmë këtë kategori të bizneseve.
- Çka po ndodhë me teatrin "Dodona", është emëruar drejtori i teatrit "Dodona" apo ende nuk është emëruar.
- Sipas disa shqetësimeve të ngritura në opinion, si dhe prej shoqatave të ndryshme të cilat merren me aspektin ligjor, për disa nene të Rregullores "Prishtina Parking" po del se janë në kundërshtim me ligjet, dhe a mendoni që ta trajtojmë këtë çështje.
- Çfar po ndodhë me bursat për studentët e komunës së Prishtinës, një proces që ka filluar në shkurt edhe nuk e di që ka përfunduar, nuk e di që janë shpallur fituesit e këtyre.
- Çka po ndodhë me ndërtimin e shkollës në lagjën "Prishtina e Re" dhe po ashtu a është në plan ndërtimi i ndonjë qerdhe përfundimtare.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Sveçla, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar, Jehona Lushaku, nënkyetare, Bekim Brestovci, drejtor dhe Sibel Halimi, drejtore.

Radije Hoxhaj, për kryetarin e Komunës

- Para një viti në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës theksova problemin e botimit të dorëshkrimeve të profesoreshës Ajmone Dhomë, ku në këtë Kuvend u premtua se së shëpejti do të botohen dhe rreth kësaj çështje asgjë nuk është ndërmarrë. Kërkoi një përgjigje konkrte nga kryetari.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Hoxha, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar dhe Jehona Lushaku, nënkyetare e Komunës.

Feim Osmani, për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit, kryetarin e Komunës, nënkyetaren e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- Kam kërkuar disa herë që të hynë në buxhet ndërtimi i një shkolle në fshatin Besi, por kërkesa e jonë nuk është realizuar. Po ashtu të njëjtën kërkesë e kemi orientuar edhe në Ministrinë e Arsimit dhe kemi marrë një përgjigje pozitive, mirpo ka kërkuar që Komuna të fillojë me procedurat zyrtare të cilat duhet të komunikohen ose ti drejtohet Ministrisë përfundimtare që i ka përgjegjësi Komuna. Kërkoh sa më

shpejtë të fillohet me procedura dhe të realizohet ky projekt i cili është shumë i nevojshëm për një shkollë e cila ka një numër afér 500 nxënës.

Në adresë të të njëjtës shkollë ka ardhur një padi nga një banor i fshatit Prugoc, e që kjo parcelë është blerë nga shkolla në vitet '90 ka kërkuar që ti kthehet kjo parcelë, ose ti shpronësohet me ligjet në fuqi që i ka Kosova, por unë dhe gjithë banorët e zonës e dimë ajo tokë i është paguar atëherë, mirëpo nuk është regjistruar në kadastër për shkak të masave që kanë qenë në ato vite. Kërkoi nga kryetari, nënkyetari dhe drejtoresha të merrën me këtë qështje, sepse është fjala për një pjesë të madhe të parcelës të cilën shkolla e ka blerë dhe është gjithsesi e nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën që iu nevojitet edhe për objektin e ri të shkollës.

- Disa herë këtu para Kuvendit e kam ngritur çështjen tek autobusët e trafikut urban dhe kërkoi të dijë se a do të ket linjë të autobusit deri në Teneshdoll që të përfshihen të gjitha fshatrat e linjës në drejtim të Podujevës nga Prishtina.
- Po ashtu kërkojmë që të jet një kujdes më i shtuar për nyjet sanitare dhe infrastrukturën përcjellëse të fshatrave tek të cilat kalon tani ndërtimi i rrugës magjistrale Prishtinë - Podujevë, pasi që ka ankesa të banorëve përfundim me ujë, disa puseta që mund të mbesin jashtë funksionit, për disa linja të elektricitetit e shumë të tjera në segmentin nga Bardhoshi deri në Teneshdoll.
- Gjithashtu është më se e domosdoshme prerja e shkurreve dhe degëve në rrugën dytësore të fshatrave për Besi, Rimanishtë dhe Teneshdoll, të cilat dëmtojnë qarkullimin normal në këto rrugë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, përgjigje dhanë Jehona Lushaku, nënkyetare, Përparim Rama, kryetar dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës, dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.

- Banorët e banesave të bardha në lagjën 'Bregu i Diellit' kërkojnë që të bëhet përfundimi i punëve aty para banesave, sepse kjo gjendje për banorët po paraqet veshtësi në lëvizjen e tyre. Kërkoi nga ekzekutivi që kjo kërkesë e banorëve të merret parasysh.
- Po ashtu kërkoi nga Drejtoria e Shëndetësisë që të merren masa në parandalimin e kariesit tek nxënësit në shkolla pasi që ata po kanë probleme me shëndetin oral.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, Izet Sadiku, drejtor dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- A do të ket ndonjë linjë të autobusit të trafikut urban fshatrat, si Barileva, Prugovci, Vranidolli, Besia.
- Pse ka ndërprerje asfaltimi i rrugës prej fshatit Bardhosh, aty prej urës që e lidhë me rrugën, që përkon deri tek rruga magjistrale që e lidhë Barilevën dhe Prugovcin.

Pas rregullimit të kësaj rruge janë vendosur edhe pusetat komplet, por ato tani janë hapura dhe po paraqesin rrezik për vozitësit. Kërkoj që këto pusetat të mbulohe. Po ashtu a është paraparë rregullimi i trotuarit.

- Pse po ka ndërprerje të grumbullimit të mbeturinave dhe në mungesë të marrjes së tyra ato po qëndrojnë para shtëpive.

Lidhur me pyetjet e paraqitura nga znj. Berisha, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Nora Kelmendi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Sinkronizimi i semaforëve në kryeqytet nuk është në nivelin e duhur, e dimë se në disa kryqëzime të rrugëve, disa semaforë mbyllen shum shpejt e disa të tjera mbesin më gjat, kështu që aty bëhet një katrahurë e madhe.
- Kur do të arrijnë autobusët e rinjë në mënyrë që ti kemi edhe linjat e reja të autobusëve, drejtori na tregon që do të arrijnë por kohën nuk e specifikoi.
- Pse faturat e mbeturinave nuk dërgohen tek qytetarët përmes postes, por ata janë të detyruar të të vijnë në Komunë të presin në radhë në sportele që ta marrin faturën për mbeturina. Kur do të filloj shpërndarja e tyre.

Lidhur me kërkesen e znj. Kelmendi, përgjigje dhan Përparim Rama, kryetar dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- Banorët e lagjes "Kodra e Trimave", dëshirojnë të dijnë se kur do të përfundojnë rrugët "Mic Sokoli" dhe "27 Nëntori", sepse ka disa muaj që ka filluar rregullimi i tyre e në këtë mënyrë po paraqet problem për banorët.
- Një deponi e mbeturinave e krijuar te bazeni, në rrugën "Nexhmi Llumnica", dhe prania e tyre po e rrezikon shëndetin e banorëve.
- Në lagjen "Kodra e Trimave" në rrugën "Agim Osaj" është krijuar një deponi shumë e madhe mbeturinave kështu që është kërkesë urgjente e banorëve sa më parë të bëhet pastrimi i kësaj hapësirave.
- Banorët afër rrugës "Hakif Sheholli" kërkojnë të bëhet pastrimi i kësaj rruge nga mbeturinat inerte që janë në këtë pjesë si dhe kërkojnë të bëhet edhe pastrimi, kontrollimi i nënkalimit përboll xhamisë së Llapit i cili nuk është duke u shfrytëzuar nga qytetarët por nga personat e padëshiruar për lagjen.

Lidhur me pyetjet e z. Krasniqi, përgjigje dhan Përparim Rama, kryetar dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Gresa Lahu, për nënkyetarin e Komunës, për drejtoren e Drejtorisë së Kulturës, për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.

- Çka është duke ndodhur me konkursin e fundit publik nga Komuna e Prishtinës në Urgjencën e kryeqytetit me shpalljen e rezultateve me shkrim, nuk ka pasur publikim të rezultateve, meqenëse institucioni përkatës nuk e ka bërë publikimin e

rezultateve dhe në ndërkoħe shihet tē ketē pasur aspak transparencë dhe pēr këtē arsyē tē njëjtit kanë dërguar ankesë në Komunën e Prishtinës dhe në Inspektoratin e punës.

- Eshtë kërkesë nga studentët, e UP-së për rregullimin e orarit në bibliotekën "Hivzi Sylejmani", për zgjatjen realisht të këtij orari, sepse biblioteka punon deri në ora 19:00.
 - Kërkoi të dijë arsyen e mos dekorimit të qytetit, rregullimi i sheshit gjatë muajit të ramazanit ashtu siç e kemi kërkuar, meqë një numër i madh i besimtarëve i frekuentojnë edhe sheshet gjatë këtij muaji siç ndodhë edhe për besimtarë të tjerë të fesë tjeter.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Lahu, përgjigje dhan Izet Sadiku, drejtor dhe Alban Zogaj, nënkyrjetar.

Leutrim Retkoceri, për kryetarin e Komunës

- Në medie është paraqitur një lajm me disa incizime të ndërtimëve pa leje në lagjen "Lakërishta" dhe kërkoj të dijë se a është ndërmarrë diçka në lidhje me atë rast.
 - Po ashtu disa ndërtimë pa leje në fshatin Shkabaj, që ka vendime që jan nxjerrë për parandalimin tyre nga inspektorati dhe ekzekutim të atyre vendimeve nuk ka
 - Gjithashtu sipa medieve jemi njoftuar edhe për disa hapa tjerë të tenderimeve, ku shqetësuese është rasti që për disa raste fituesit të tenderëve po dalin të jenë njerëz të afërt të komunës ose të kryetarit, është rasti për digitalizimin e hapësirave publike, vlera e projektit 2.4 milion euro, ka qenë gjithashtu digjitalizimi në arsim një vlerë e madhe dhe nuk është që kemi dëgjuar një përgjigje të tillë.
 - Krahasuar me vitin 2023, është, andaj çfarë procedure është zhvilluar edhe çka ka ndikuar një shpenzim i kësaj vlere kaq të lartë në paga dhe mëditje.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Retkoceri, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Valbona Makolli, drejtore.

Faton Zeka, për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit, dhe për kryetarin e Komunës

- A ka mundësi me u përfshirë në kontratë edhe dhënia në shfrytëzim për sportistë të lagjeve që janë afër me Don Boskon, klube formale dhe jo formale që kanë nevojë me pasë një sallë publike, siç janë shkollat publike që me pasë mundësinë me i shfrytëzuar sallat e shkollave sepse edhe ashtu në vikend nuk është që janë të zëna.
 - A do të kishte mundësi që edhe për Obiliq të jet një linjë e transportit, ashtu siç është për Fushë Kosovë
 - Kërkoi të dijë se çka është duke ndodhur për Rregullorja e ndërtimeve të përkohshme me karakter të përkohshëm montazh e cila është e anuluar.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Zeka, përgjigje dhan Përparim Rama, kryetar dhe Jehona Lushaku, nënkrvetare.

Sami Salihu, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Kërkoi nga kjo drejtori që në lagjen "Dardania" të bëhet pastrimi dhe funksionalizimi i Kroit të bardhë, meqenëse është një ndër vendet më të frekuentuara të lagjes.
- Gjatë muajit mars dhe prill KEDS-i i ka bërë disa punime duke i demoluar rrugët dhe trotuaret në lagjen "Dardania" dhe pas kryerjes së këtyre punimeve nuk i kanë rregulluar dëmet e shkaktuara.
- Banorët e lagjes "Kolovica" po hasin shum parregullsi ndaj operatorit privat dhe kërkojn që kjo çështje të trajtohet nga drejtoria përkatëse.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Salihu, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Radije Hoxhaj, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Ka më se një vit e disa muaj që i kam artikuluar dy kërkesa dhe deri më tanë për asnjëren nuk kam marrë asnjë përgjigje. Për në lagjen "Bregu i Diellit" për te ambulanta e kemi linjën nr.3 që na shpie në qytet, ndërsa me u kthe duhem me linjën nr.4 e cila nuk e përshkon rrugën kah ambulanta, u premtua që do të bëhet zgjidhje, por ja që nuk është bërë.
- Kërkoi të dij arsyen e mos rregullimit të emrit të rrugës "Mark Dizdar" afér spitalit, është shkruar gabimisht e duhet të jet "Mak Dizdar".

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga znj. Hoxhaj, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Pika e katërbëdhjetë

Të ndryshme

Gëzim Sveçla tha se në lagjen "Lakrishta" një objekt diku mbi 2000 mijë metra katrор, ku drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit ka pranuar që aty kemi të bëjmë me një tejkalim të lejes ndërtimore dhe thotë decitivisht se palës i është shkruar një gjobë mandatore. Pas një kohe është thënë se që kjo qështje është rregulluar përmes lejes përmes Drejtorisë së Urbanizmit, do të thotë për një qështje fillimisht ka pranuar që ka tejkalim të lejes ka pranuar që pala e ka shkelë ligjin, ndërkohë pas një periudhe një vjeçare thotë që kjo qështje është rregulluar me leje. Lidhur me këtë çëshje kërkoi një përgjigje nga ana e kzekutivit.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Sveçla, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Ermal Osmani tha se është kërkesë e imamit të xhamisë së Qarshisë që shpenziomet të cilat bëhet me rastin e ndriçimit të kësaj xhamie të mbulohen nga ana e Komunës, pasi që ndriçimi paguhet prej kontributit të qytetarëve të cilët kontribuojnë në arkat e bamirësisë që gjinden në atë xhami. Gjithashtu ajo xhami së shpejti besoj që do ta bënë një kërkesë në drejtorinë përkatëse për ndërtimin e një vendi ku përdoret nga qytetarët si vend më të përshtatshëm ku mirët abdes për me i kryer ritualet fetare, për shkak se është vendi për

abdes por në kohët kur është ftoftë është e pamundur me marrë abdes sepse gjendet jashtë.

Po ashtu në lagjen "Bregun e Diellit", është një zonë me shtëpia përballë palestrës "1 Tetori", e cila ka mbetur pa ndonjë koeficient të ndërtimit, ku rrëth kësaj zone po ndërtohet me koeficient të kënaqshëm si mbas banorëve por kjo zonë ka mbetur pa u definuar koeficienti edhe qytetarët nuk po dinë se ku të orjentohen më sakt për zgjidhjen e këtij problemi.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Osmani, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Faton Zeka tha se ne lagjen "Kalabria" disa hapësira publike po uzurpojnë me ndërtimet nga disa persona të pa ndërgjegjshëm, andaj kërkoi që për këtë dukuri shqetësuese të merren masa në parandalimin e tyre.

Për çështjen e ngritur nga z. Zeka, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

